VENDIM
Nr. 316, datë 2.6.2021

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 499, DATË 19.7.2006, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË DIVJAKË TË QARKUT TË FIERIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 5, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e inventarit, të miratuar me vendimin nr. 499, datë 19.7.2006, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Shtohen pronat me numrat rendorë 745–767, sipas formularëve, lidhjes 1 dhe plan-vendosjeve, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij;

b) Pronës me numër rendor 708 i ndryshon emërtimi dhe sipërfaqja, sipas formularit dhe plan-vendosjeve, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Pronat, të cilat janë brenda territorit të Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta, të përdoren vetëm si destinacion bujqësor.

3. Ngarkohen Bashkia Divjakë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Lidhja nr.1

Bashkia Divjakë

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
765, 766	Pyje dhe kullota	Në pronësi
745–764	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
767	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka inproduktive ledh)	Në pronësi

ITETERORE

11

BASHKIA DIVJAKË

Drejtori i Z.M.M.T DIVJAKË : Dorjan SPAHO

Përgatiti: Specialist Ing.Gjeodet: Blerim PASKU

KRYETARI I BASHKISË
Fredi BOKONESHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË

A. IDENTIFIKIMI I PASURISË

ZONA KADASTRALE: 1708 NR.I.PASURISË: 132/16 Vol 03 Fq 209

INDEKSI I HARTËS: K-34-112-(3-A) SHKALLA: 1:2500

ADRESA E PASURISË: Gërmenj i Madh Q/F DIVJAKË

Rr_____ P/G SH K AP

B. KUFIZIMET

VERI:
JUG:
LINDJE:
PERËNDIM:

C. PRONARI

SHTET

D.Data: _____ Ora:

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE KRGJSH



Point Nr	East	Nord
1	464018.487	4540220.752
2	463981.370	4540197.588
3	464007.799	4540291.655
4	464037.374	4540275.742